



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC

KRYETARI

7323
Nr. Prot.

Roskovec, me 7.12.2019

V E N D I M

“PER

MIRATIMIN E RREGULLORES PER PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TE INTERSAVE NE USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE NE BASHKINE ROSKOVEC

Ne mbeshtetje te Ligjit 139/2015 “Per vetqeverisjen vendore”; Ligjit nr.9367, date 7.4.2005 “Per parandalimin e konfliktit te ineteresave ne ushtrimin e funksioneve publike” I ndryshuar, neni 46,

V E N D O S A:

1. Miratimin e “Rregullores per Parandalimin e Konfliktit te Interesave ne Ushtrimin e Funksioneve Publike” ne bashkine Roskovec .
2. Ngarkohet Autoriteti Pergjegjese per Parandalimin e Konfliktit te Interesave, t’i bejne te njohur kete akt te gjithe punonjesve te administrates se bashkise Roskovec .
3. Rregullorja perbehet nga 26 (njetete e gjashte) nene dhe nenshkuar ne cdo flete nga njesia pergjegjese.
4. Cdo punonjes te nenshkruaje ne nje liste emerore te posacme per njohjen e kesaj rregulloreje.
5. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETAR

Majlinda Buri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KRYETARI

RREGULLORE

**PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË
INTERESAVE**

NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE

NË BASHKINË ROSKOVEC





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC

AUTORITETI PERGJEGJES PER PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TE INETERESAVE

Nr. 7322 Prot.

Roskovec, më 17.12.2019

Lenda: Shkrese percjellese

INSPEKTORIATIT TE LARTE TE DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TE
PASURIVE DHE KONFLIKTIT TE INTERESAVE

TIRANE

Ne baze te Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, neni 46, Ju dergojme nje kopje te Vendimit Nr. 7323 Prot, date 17.12.2019 “Per Miratimin e Rregullores per Prandalimin e Konfliktit te Interesave ne Ushtrimin e Funksioneve Publike ne Bashkine Roskovec”.
Bashkengjitur nje kopje e rregullores dhe ne format CD.

Duke Ju falenderuar per bashkepunimin dhe mirkuptimin Tuaj!

Autoriteti pergjegjes per parandalimin e konfliktit te interesave

Olta Brahushi

Maltin Lamaj

Pavlina Braho



KREU I RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Baza ligjore

Rregullorja "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike si dhe deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike", në Bashkinë Roskovec, bazohet në ligjin nr. 139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", Vendimin date.18.02.2019 për miratimin e rregullores "Vendimin date.18.02.2019 për miratimin e rregullores "Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Roskovec" per vitin 2019

, ligjin nr. 9367, datë 17.12.2015, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar dhe në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore përkatëse të miratuara në bazë të tyre,

Neni 2 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është deklarimi dhe mbajtja e përgjegjësive për deklarimin dhe kontrollin e pasurive si dhe garantimi i një vendimmarrje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të publikut nga zyrtarët e Bashkisë Roskovec , si dhe garantimin e ushtrimit të funksioneve nga punonjësit e Bashkisë Roskovec, në kushtet e konfliktit të interesave.

Neni 3 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, mjeteve, mënyrave, procedurave dhe përgjegjësive si dhe kompetencave për zbatimin e detyrimeve ligjore për deklarimet e pasurive si dhe identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajnimin, zgjidhjen dhe dënimin e rasteve të konfliktit të interesave.

Neni 4 Përkufizime

1. "Zyrtar" është çdo person, që kryen detyra dhe ushtron funksione publike në Bashkinë Roskovec.
2. "Person i lidhur me një zyrtar të bashkisë" është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasurore ose vetjake jo pasurore, me zyrtarin sipas përcaktimit të pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.
3. "Parim i proporcionalitetit" (sipas nenit 46 te ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar), është raporti ndërmjet rëndësisë së detyrave, përgjegjësive dhe kompetencave të një zyrtari të Bashkisë Roskovec me masat për parandalimin e konfliktit të interesave, raport në të cilin sa më të rëndësishme të jenë detyrat, përgjegjësitë dhe/ose kompetencat e tij, aq më të shumta janë kufizimet e interesave vetjakë.



Neni 5

Fusha e zbatimit

Rregullorja përcakton norma të detyrueshme për t'u zbatuar nga:

1. Çdo zyrtar i Bashkinë Roskovec, që ndodhet në pozicione, ka përgjegjësi, kryen detyra ose ushtron kompetenca të llojeve konkrete, të përcaktuara shprehimisht në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, dhe në ligjin nr.9049, datë 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar.
2. Çdo zyrtar i Bashkisë Roskovec, kur ai merr pjesë në një vendimarrje për akte dhe kontrata administrative;
3. Çdo zyrtar i Bashkisë Roskovec, kur ai merr pjesë në një vendimarrje për kontrata civile, që krijojnë marrëdhënie juridiko-civile, me palë këto subjekte;
4. Personat e lidhur në masën dhe mënyrën e përcaktuar në ligjin nr.44/2015 "Kodit të Procedurave Administrative".

Neni 6

Vendimarrja dhe çastet paraprake të vendimarrjes

Për qëllimet e kësaj rregulloreje:

- a) vendimarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit;
- b) vendimarrje për një akt do të vlerësohen edhe ato çaste paraprake të vendimarrjes, sipas shkronjës "a" të kësaj pike, të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit, që përfshijnë, por nuk janë të kufizuara si më poshtë:
 - i) hartimin e projekt aktit nga zyrtari ose zyrtarët dhe dorëzimin organit apo zyrtarit kompetent për vendimarrje;
 - ii) dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuara, për këtë projekt akt nga zyrtarë të tjerë, brenda apo jashtë institucionit;
 - iii) dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuara, nga çdo zyrtar si pasojë e kërkesave, pretendimeve apo informacioneve të subjekteve të interesuara për këtë projekt akt;
 - iv) dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuara, të çdo zyrtari me kompetencë për të vendosur përfundimisht për aktin;
 - v) përfshirjen e çdo dokumenti paraprak, ndërmjetës dhe/ose shoqërues të një vendimarrjeje për një akt ose kontratë që lidhet kryesisht me organizimin, të ardhurat, shpenzimet, strategjitë, burimet njerëzore, funksionet, detyrat e përgjegjësitë administrative pa praninë e të cilëve nuk do të vendosej dhe mbështetej përmbajtja përfundimtare e projekt aktit ose projekt-kontratës në tërësinë e tyre;
 - vi) çdo rast tjetër në përputhje me specifikat konkrete e përkatëse të misionit e të veprimtarisë së Bashkisë Roskovec.



Neni 7

Kompetenca thelbësore dhe përcaktuese për një akt

1. Një zyrtar i Bashkisë Roskovec, ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt, nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në vendimmarrjen për këtë akt, sipas nenit 4 të rregullores, përcaktojnë përmbajtjen e aktit.
2. Si kompetencë thelbësore e përcaktuese e një zyrtari për një akt, përfshihet, në secilin nga çastet paraprake të mësipërme të vendimmarrjes, mundësia për të ndikuar mbi vendimmarrjen që buron nga:
 - a) roli zyrtar urdhërues, propozues, këshillues, zbatues ose kontrollues i ushtruar, që rrjedh nga pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi në përgatitjen, negocimin, propozimin, këshillimin, miratimin, administrimin, kontrollin ose ekzekutimin e një akti apo kontrate;
 - b) zotërimi i informacionit, që lidhet kryesisht me të dhëna sensitive për subjektet dhe ose ish-subjektet e Bashkisë Roskovec, të dhëna për tatimet e doganat, kuadrin rregullator, informacione sensitive personale, informacione për organet e hetimit e të ndjekjes, informacione për politikat ekonomike qeveritare dhe administrimin financiar;
 - c) çdo shkak tjetër në përputhje me specifikat konkrete e përkatëse të funksionit e të veprimtarisë së zyrtarëve të Bashkisë Roskovec.
3. Pavarësisht nga përcaktimet e pikave të mësipërme të kësaj rregulloreje, përbën çast paraprak të vendimmarrjes apo kompetencë thelbësore e përcaktuese për një akt ose kontratë, çdo rast i vlerësuar si i tillë nga autoriteti përgjegjës i Bashkisë Roskovec, si dhe nga zyrtarët-eprorë në institucion.
4. Në secilin prej çasteve të mësipërme, zyrtari, pjesëmarrës në vendimmarrje, me kompetencë thelbësore dhe përcaktuese, është i detyruar të deklarojë, në zbatim të pikës 1 të nenit 7 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, nëse ka një interes privat që mund të shkaktojë rënien në konflikt interesi të çfarëdo lloji,
5. Në të njëjtat raste, eprori ose institucioni epror mund t'i kërkojë zyrtarit të deklarojë rast pas rasti interesat private në zbatim të nenit 7, pikës 2 të ligjit 9367 datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.
6. Kur vlerësohet se ka rrezik për rënien në konflikt interesi të zyrtarit, veprohet sipas nenit 37 të ligjit nr. 9367 datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.

Neni 8

Interesat private

1. Interesat private të një zyrtari janë ato interesa që parashikon neni 5 i ligjit nr. 9367 datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, e konkretisht:
 - a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre;
 - b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile;
 - c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale;
 - ç) negociime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negociime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës;
 - d) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër;
 - dh) marrëdhënie:



- i) familjare apo të bashkëjetesës;
 - ii) të komunitetit;
 - iii) etnike;
 - iv) fetare;
 - v) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë;
- e) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e mësipërme të këtij neni.
2. Kufizimet e interesave privatë, të përcaktuara shprehimisht në ligjin 9367 datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, zbatohen së bashku me kufizimet e të njëjtit interes privat, të përcaktuara shprehimisht në një ligj tjetër, sipas parimit, që zbatohet ai kufizim që është më i rreptë.
3. Nëse në ligjin nr. 9367 datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, në lidhje me një interes të caktuar privat të një zyrtari, nuk është përcaktuar ndonjë kufi sasior i kufizimit të këtij interesi, ndërsa në një ligj tjetër i njëjti interes, me qëllim parandalimin e konfliktit të interesave, kufizohet shprehimisht sipas një kufiri sasior, atëherë ky kufizim zbatohet edhe për kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 9367 datë 07.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, dhe anasjelltas.
4. Vlerësohet shkak për lindjen e konfliktit të interesit, çdo lloj interesi privat i zyrtarit nga ata të përcaktuar në nenin 5 të ligjit nr. 9367 datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, çdo lidhje apo gërshetim ndërmjet dy a më shumë prej tyre, nëse për shkak të këtij interesi ose për shkak të daljes jashtë kufizimeve të detyrueshme të këtij interesi, shfaqet një gjendje me konflikt interesi, sipas përkufizimeve të pikave 1 e 4 të nenit 3 të ligjit të lartpërmendur.

KREU II

PROCEDURAT DHE MJETET PËR IDENTIFIKIMIN DHE REGJISTRIMIN E KONFLIKTEVE RAST PAS RASTI TË INTERESAVE

Seksioni 1

Identifikimi dhe regjistrimi i interesave në kushtet e konflikteve rast për rast të interesave Neni 9

Deklarimi rast për rast i interesave privatë të zyrtarit

1. Çdo zyrtar i Bashkisë Roskovec, që përgatit raportet për kontroll të plotë në verifikimin e deklaratave të interesave private periodike të subjekteve të bashkisë, që mbikëqyrin ose përdorin fonde publike, që lidhin kontrata shërbimi, investimi, që përfaqësojnë bashkinë në marrëdhënie me të tretët, në ushtrimin e kompetencave ose në kryerjen e detyrave të tyre funksionale ose të ngarkuara përkohësisht, detyrohet të bëjë vetë deklaram paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat, që mund të bëhet shkak për lindjen e konfliktit të interesit.
2. Deklarimi, si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi kërkohet dhe bëhet sa më shpejt të jetë e mundur.
5. Vetë deklarimi ose deklarimi me kërkesë bëhet me shkrim, kur zyrtari ose punonjësi përfshihet në një vendimmarrje për një akt dhe/ose për subjekte të deklarimit periodik të interesave private në Bashki.



Neni 10

Identifikimi i interesave privatë të zyrtarit nga persona të tretë .

1. Ofrimi i informacionit, për interesat privatë të zyrtarit në Bashki, është:
 - a) detyrë e çdo zyrtari që ka dijani;
 - b) e drejtë e palëve të interesuara dhe e çdo personi, që ka dijani dhe që ka një interes në përgjithësi e që përputhet me qëllimin e ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.
2. Burime të tjera informacioni për interesat privatë të një zyrtari dhe punonjësi të Bashkisë mund të jenë edhe ato burime të parashikuara në nenin 9 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.

Neni 11

Lëshimi i autorizimit nga zyrtari i Bashkisë

1. Bashkia Roskovec ngarkon Drejtorinë e burimeve njerezore dhe Sherbimeve mbeshtetese që tëvërë në dispozicion të zyrtarëve të saj modelin e autorizimit, në formë e në përmbajtje, që këta duhet të lëshojnë.
2. Çdo zyrtar, jo më vonë se 30 ditë nga data e fillimit të marrëdhënieve të punës në një institucion publik, është i detyruar të lëshojë një autorizim, në favor të institucionit publik ku ushtron funksionet, nëpërmjet të cilit ai e autorizon këtë institucion që të kryejë kontroll dhe të sigurojë të dhëna vetjake për zyrtarin, kudo ku ato janë regjistruar në bazë të nenit 10 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, të dorëzojnë autorizimin.
3. Autorizimet dorezohen dhe administrohen nga Autoriteti përgjegjës, i cili emerohet me urdher të titullarit të institucionit.

Neni 12

Autoritetet Përgjegjëse për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave

1. Autoriteti/struktura përgjegjëse për zbatimin e ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar dhe ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar sipas hierarkisë në bashkinë Roskovec, janë:
 - a. Titullari i institucionit
2. Autoriteti përgjegjës për institucionin e bashkisë Roskovec, ngrihet me urdher të titullarit të bashkisë Roskovec, i cili zbaton detyrat e percaktuara në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar dhe nenit 13 të kësaj rregullore, si më poshtë vijon.

Neni 13

Detyrat e Autoritetit Përgjegjës

Autoriteti Përgjegjës i institucionit, kryen detyrat e mëposhtme:



- a) mbledh dhe dokumenton interesat private të zyrtarëve të institucionit;
- b) shpërndan dhe mbledh autorizimet e detyrueshme për t'u lëshuar nga zyrtarët e bashkisë, sipas nenit 10 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.
- c) informon me shkrim ILDKPKI për largimet apo emërimet e reja të zyrtarëve të cilët mbartin detyrim për deklarim të interesave private;
- ç) krijon regjistrin përkatës dhe mban regjistrimet rast për rast të konfliktit të interesit;
- d) bazuar në regjistrimin dhe vlerësimin e interesave private të zyrtarëve të bashkisë, u sugjeron atyre dhe/ose eprorëve të tyre, çështjet dhe momentet kur zyrtarët, dhe/ose eprorët e tyre duhet të tregohen të kujdesshëm për parandalimin e:
- i. konfliktit rast për rast të interesit (faktik, në dukje dhe të mundshëm);
 - ii. konfliktit të vazhdueshëm të interesit;
- dh) kryen me autorizim të kryetarit të bashkisë, verifikim të interesave të deklaruara apo të padeklaruara të zyrtarëve dhe punonjësve të këtij institucioni, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë që i jep ligji.
- e) mbështet eprorin e zyrtarit në vlerësimin e kryerjes së padrejtë të detyrave për shkak të konfliktit të interesit, në marrjen e masave disiplinore apo në propozimin për vendosjen e gjobave në rast kundërvajtjesh administrative të zyrtarit, në kuptim të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.
- i) informon, këshillon e trajnon zyrtarët në lidhje me këtë ligj, me të drejtat e detyrimit e tyre dhe me parandalimin sa më të mirë të konfliktit të interesave;
- ë) merr masa për të siguruar aksesin e informimit e publikut në të dhënat personale të zyrtarëve dhe në dokumentet e tjera zyrtare që lidhen me konfliktin e interesit;
- f) në bashkëpunim me Drejtorinë burimeve njerezore dhe shërbimeve mbështetese:
- i. marrin masa për të lehtësuar ankimin administrativ të palëve të interesuara në lidhje me aktet e marra në konflikt interesi, zyrtarëve përgjegjës, si dhe mbështesin bashkinë në ndërmarrjen e hapave ligjore për dëmshpërblimin e palëve të treta të dëmtuara dhe kalimin e barrës së dëmshpërblimit të zyrtarët përgjegjës;
 - ii. orientojnë, vlerësojnë, kontrollojnë apo kryejnë hetim administrativ në lidhje me konfliktin e interesit të zyrtarëve të bashkisë.
 - iii. marrin masa për të miratuar rregulloren e konfliktit të interesit.
- g) mbështet zyrtarët që mbartin detyrim për deklarim në kryerjen e deklarimit periodik të interesave;
- gj) bëne me dije zyrtarët dhe punonjësit që mbartin detyrim për deklarim për çdo këshillë apo udhëzim të Kuvendit të RSH-së dhe ILDKPKI-së;
- h) mbështet misionet monitoruese, vlerësuese apo të verifikimit dhe të hetimit administrativ të ILDKPKI-së për zyrtarët e këtij institucioni;

Neni 14

Regjistri i konflikteve rast për rast të interesave

1. Për regjistrimet e konflikteve rast për rast të interesave të zyrtarëve të bashkisë , krijohet regjistri me të njëjtin emër.
2. Regjistri i konflikteve rast për rast të interesave, administrohet nga Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerezore"

Neni 15



Administrimi i dokumentacionit nga Autoriteti Përgjegjës

1. Dokumentacioni i përdorur nga Autoriteti Përgjegjës, në zbatim të ligjit nr.9367, datë 07.04.2014 Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar dhe në zbatim të kësaj rregulloreje, është dokumentacion zyrtar. Në rast largimi nga detyra, bëhet dorëzimi i gjithë dokumentacionit me procesverbal sipas rregullave të caktuara.
2. Me qëllim administrimin sa më të mirë të dokumentacionit nga Autoriteti Përgjegjës, krijohen dosje të veçanta me përmbajtje si vijon:

- **Dosja nr.1, me titull “Për aktet ligjore e nënligjore”:**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Ligji 139/2015 Per vetqerisjen vendore"
- Ligji nr.9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publike”, (i ndryshuar);
- Ligji nr.9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (i ndryshuar);
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”;
- Ligji nr.9131, datë 08.09.2003/ "Për rregullat e etikës në administratën publike";
- Ligji nr.8503, datë 30.06.1999, “Për të drejtën e informimit dhe dokumentet zyrtare”;
- Ligji nr.8517, datë 22.07.1999, "Për mbrojtjen e të dhënave personale";
- Komentarët ligjorë të ILDKPDI-së;
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- Cdo akt ligjor/nenligjor qe ka lidhje me kete rregullore

- **Dosja nr.2, me titull, “Për identifikimin dhe regjistrimin e konfliktit rast për rast të interesave”:**

- Regjistri për regjistrim të konfliktit rast për rast të interesave, në formë libri,
- Autorizimet e plotësuara nga zyrtarët për deklarimin rast për rast të intërsave;
- Deklaratat e plotësuara nga zyrtarët për konfliktin rast për rast të interesave;
- Informacionet e marra nga publiku, nga media apo nga burime të tjera të ligjshme për konfliktin rast për rast të interesave të zyrtarëve;
- regjistrimet e bëra në regjistrat publikë dhe privatë;

- **Dosja nr.3, me titull “Për regjistrimin e deklarimeve periodike të pasurive dhe të interesave të zyrtarëve, që bartin detyrim për deklarim në ILDKPKI”:**

- Regjistri themeltar alfabetik nr. 1, me emrat dhe funksionet e zyrtarëve që deklarojnë në ILDKPKI;
- Kopje të njoftimeve ndaj zyrtarëve për deklarim dhe konfirmimet e tyre;
- Kopje të shkresave për deklarata te dorëzuara në ildkpkI;



- Kopje të formularit për listën e zyrtareve, që nuk kanë deklaruar në afat dhe shkaqet e mosdeklarimit në afat;
- Librin për dorëzimin e deklaratave të pasurisë, ku zyrtari nënshkruan për datën e dorëzimit.

Neni 16

Regjistrimet rast për rast të konflikteve të interesit

Autoriteti përgjegjës për bashkinë Roskovec, për çdo rast të shfaqjes së një konflikti rast për rast të interesit, regjistron:

- identitetin e zyrtarit të institucionit,
- interesat privatë të tij,
- shkakun për konflikt interesi,
- thelbin e konfliktit,
- palët e interesuara,
- burimin e të dhënave,
- mënyrën e marrjes dhe të verifikimit të tyre, si dhe vendimin që është marrë, mbështetur në këto të dhëna, përfshirë edhe vendimet e marra nga eprorët, nga Kuvendi ose nga gjykatat.

Seksioni 2

Identifikimi dhe regjistrimi periodik i interesave private

Neni 17

Zyrtarët që mbartin detyrimin për deklarim periodik të interesave private

1. Deklarimi periodik i interesave privat të bashkisë behet në përmbajtje të kërkesave të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike (i ndryshuar). Zyrtarët e Bashkisë, të cilët janë të detyruar të bëjnë deklarim të interesave periodike janë:

a) Kryetari i bashkisë

Gjithashtu, në zbatim të nenit 21 dhe 22 të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, mbartin detyrim për deklarim të interesave periodike bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët madhorë të zyrtarëve të bashkisë, të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, edhe kur këta të fundit nuk janë në të njëjtën gjendje.

2. Çdo zyrtar i Bashkisë, i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, në rast largimi nga funksioni dhe në rast se nuk është më subjekt i deklarimit të interesave private periodike në ILDKPKI, ose kur kalon në një pozicion që nuk mbart detyrimin për deklarim, është i detyruar, që brenda 15 ditëve nga data e largimit nga funksioni, të plotësojë dokumentin zyrtar "Deklarate pas largimit nga funksioni". Drejtoria juridike dhe e burimeve njerëzore, nuk mund të bëjnë dorëzimin e librezës së punës apo të çdo dokumenti tjetër, si dhe pagimin e pagës së fundit dhe/ose shpërblimeve që mund t'i takojnë në rast se ky i fundit nuk plotëson këto detyrim ligjor.



Neni 18
Llojet e interesave private qe deklarohen periodikisht

Interesat private qe deklarohen periodikisht jane te percaktuara në nenin 4, te Ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë", (i ndryshuar);

Neni 19
Kufizimi i interesave privatë për parandalimin e konfliktit rast për rast të interesit për çështje të veçanta

Ndalimet dhe kufizimet për zyrtarët, të përcaktuar si në pikën 1 të nenit 4 të ligjit nr. nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", zbatohen edhe për personat e lidhur me ta, bashkëshorti/ja, fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit dhe bashkëshortit/es, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 24 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2003, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.

1. Kryetari i bashkise
 - a) nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër publik;
 - b) nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari tjetër fitimprurëse, me përjashtim të mësimdhënies;
 - c) nuk mund të zotërojë në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, të çdo forme.

Neni 20
Prania dhe kufizimi i interesave privatë të personave të lidhur me zyrtarin

1. Person i lidhur me zyrtarin e bashkisë , për kufizimet e interesave privatë të zyrtarëve, të përcaktuar në nenin 17 të kësaj rregulloreje janë përkatësisht:
 - a) bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore, prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/ja;
 - b) çdo person fizik ose juridik, i cili, në lidhje me dhuratën, favorin, premtimin ose trajtimin preferencial, luan rolin e ndërmjetësit a të shkëmbyesit të interesave të lindur nga ky veprim.
2. Ndalimet dhe kufizimet për zyrtarin e bashkisë, të përcaktuara në këtë rregullore, zbatohen edhe për personat e lidhur me të, në përputhje me pikën 1 të këtij neni,
3. Përsa i përket kufijve të zotërimit të aksioneve ose të pjesëve në kapital, për zyrtarin e bashkisë dhe personin e lidhur me të, zbatohen drejtëpërdrejt parashikimet e nenit 24, pikat 4 e 5 dhe nenit 35, pikat 2 e 3, të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.
4. Personi i lidhur me zyrtarin e Bashkisë Roskovec, nuk mund të ushtrojë veprimtari si person



fizik tregtar ose ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, nëse veprimtaria përputhet ose pritet me sferën e juridiksionit të zyrtarit të bashkisë dhe të kompetencës së tij për të vepruar, me akte individuale apo normative të nxjerra nga ai, ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve, të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitime ose kosto mbi këtë person fizik apo mbi shoqëri tregtare e persona të tjerë fizikë, që bashkëpunojnë ose konkurojnë me personin e lidhur, Kjo pikë nuk zbatohet kur plotësohet kushti i mëposhtëm: a) veprimtaria dhe/ose disa veprimtari tregtare së bashku të një personi të lidhur krijojnë një të ardhur të përgjithshme bruto vjetore, që nuk tejkalon kufirin e parashikuar nga ligji.

Neni 21

Mbrojtja për dhënien e informacioneve

1. Çdo shtetas, i cili ofron informacion të bazuar për rastet e konfliktit të interesave të padeklaruara nga zyrtarët e Bashkisë, përfiton mbrojtje të veçantë administrative, si më poshtë:

- a) zyrtari i bashkisë, për të cilin jepet informacion, nuk mund të ushtrojë asnjë kompetencë administrative me efekte ndëshkuese mbi shtetasin informues, dhe as të bëhet pengesë për fitimin e të drejtave të ligjshme nga ky i fundit për shkak të dhënies së informacionit;
- b) kur marrja e masës ndaj shtetasit që informon përcaktohet nga një shkak tjetër ligjor, ajo merret vetëm nga një zyrtar tjetër i bashkisë, që qëndron në marrëdhënie varësie vertikale mbi zyrtarin, për të cilin është dhënë informacioni.

2. Nga parashikimi i pikës 1 (b) të këtij neni bën përjashtim rasti kur marrja e masës administrative bëhet në kushtet kur konflikti i vetëm i interesit i pashmangshëm i zyrtarit të bashkisë është ai në dukje kur plotësohen kushtet e mëposhtme :

- a) kur zyrtari i bashkisë, është i pazëvendësueshëm në ushtrimin e funksioneve;
- b) kur vetëpërjashtimi i zyrtarit është i pamundur, sepse është e pamundur delegimi i kompetencave të tij tek një zyrtar tjetër, për shkak të ligjit apo për shkak të situatës;
- c) kur vendimet e zyrtarit të bashkisë, sipas rregullimeve me ligj, nuk i nënshtrohen miratimit, revokimit ose shfuqizimit nga një institucion epror;
- d) kur nuk është i mundur transferimi a tjetërsimi i interesit privat, për shkak të natyrës së tij (si lidhje familjare, komunitare etj.);
- e) kur nuk ka kuptim, që për një rast konflikti të tillë, zyrtari i bashkisë të japë detyrimisht dorëheqjen nga funksioni. Në një rast të tillë, vendimet e këtij zyrtari i nënshtrohen një kontrolli dhe vlerësimi të veçantë nga ILDKPKI, të ngarkuar me ligj për të kryer kontrollin e këtyre vendimeve. Vendimi dhe rezultatet e kontrollit bëhen kurdoherë publike,

Neni 22

Ndalimi i marrjes së dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale

1. Është e ndaluar që një zyrtar në bashki të kërkojë, të pranojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, për veten, për familjen, të afërmit, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij në institucion, nga një individ, person fizik ose juridik privat, nga subjekte të deklarimit të interesave private periodike në bashkisë, kur kjo mund të shkaktojë lindjen e një konflikti interesi të çdo lloji, ose që ndikon ose duket sikur ndikon në paanshmërinë e kryerjes së detyrës a është ose duket sikur është shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare.

a) "Dhurata", sipas kësaj rregulloreje ka të njëjtin kuptim të përcaktuar në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i



ndryshuar, dhe në VKM-në nr.714, datë 22.10.2004;

b) Nuk konsiderohen si dhurata, në kuptim të këtij neni, dhuratat, të cilat i ofrohen zyrtarit si pasojë e lidhjeve farefisnore apo njohjeve personale që ai ka me dhuruesit, si edhe në rastin kur është e qartë se dhurata nuk ka asnjë lidhje me pozicionin dhe cilësinë si nëpunës i administratës publike, të personit, që merr dhuratën.

2. Zyrtari nuk duhet që, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të japë dhurata ose të ndërmjetësojë për të dhënë dhurata për një zyrtar të një niveli më të lartë apo të aferm të tij dhe as të kërkojë ose të pranojë dhurata nga zyrtarë të një niveli më të ulët ose të aferm të tij, për shkak të cilësive dhe raporteve zyrtare.

3. Rregullat e mësipërme nuk zbatohen në rastin e ftesave të zakonshme apo kur janë të ftuar punonjës ose kolegë të tjerë, të mikpritjes tradicionale, dhuratave me vlerë simbolike apo tradicionale dhe të mirësjelljes, brenda kufijve normalë të traditës, zakoneve dhe praktikës së përditshme, të cilat nuk krijojnë dyshime për paanësinë e nëpunësit.

4. Pranimi dhe vlerësimi i dhuratave bëhet sipas rregullave të përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, dhe në VKM-në nr.714, datë 22.10.2004;

5. Në asnjë rast zyrtari i bashkisë nuk duhet të pranojë dhurata në vlerë monetare.

6. Përrjashtohen vetëm rastet e përcaktuara me akte të organeve kompetente, të cilat lejojnë pranimin e dhuratave apo trajtimeve preferenciale për arsye protokollare.

Neni 23

Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave

Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave për zyrtarët/ punonjësit e Bashkisë Roskovec bëhen sipas kreut IV të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.

Neni 24

Ndalimi i shpërdorimit të së drejtës

Asnjëra nga dispozitat e kësaj rregulloreje nuk mund të interpretohet sikur i jep zyrtarëve të bashkisë, të drejta që të ndërmarrin ndonjë veprimtari ose të kryejnë ndonjë akt që synon cënimin e parashikimeve dhe rregullave të përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, dhe në këtë rregullore.

Në mungesë të parashikimeve të veçanta në këtë rregullore, zbatohen drejtpërdrejt dispozitat e përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.

Neni 25

Njoftim i rregullores punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe bërja publike e saj

Rregullorja i bëhet e njohur çdo punonjësi të Bashkisë Roskovec nëpërmjet dërgimit si në postën



elektronike edhe në faqen zyrtare të institucionit. Drejtoria e Burimeve Juridike dhe e Burimeve Njerezore, merr masa për njohjen e saj nga çdo zyrtar i Bashkisë Roskovec dhe struktura përgjegjëse, jo më vonë se 1 (një) muaj nga miratimi i kësaj rregulloreje nga titullari i institucionit,

Neni 26
Hyrja në fuqi, shpallja publike

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë me miratimin e saj.

Autoriteti përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave

Olta Brahusi
Pavlina Braho
Maltin Lamaj

KRYETAR

Majlinda Bufi

